

Zgjedhja e rregjimit të zakonshëm



Taksapaguesit të konsideruar “mini-mi” mund të zgjedhin sidoqoftë të aplikojnë Iva e taksat me mënyrat e zakonshme.

Zgjedhja , e vlefshme të paktën për 3 vjet, duhet të komunikohet me deklarin e parë vjetor që duhet të bëjë mbas zgjedhjes së bërë. Mbas tre vjetësh zgjedhja mbetet e vlefshme për seicilin vit që vjen pas, deri kur vazhdon të mbetet aplikimi konkret i rregjimit normal. Zgjedhja e komunikuar për 2008 mund të anulohet me efekt nga periudha e tatimit të mëvonshëm.

Ndërprerja e Rregjimit Minimi:

- Nga viti mbas atij në të cilin nuk plotësohet edhe vetëm një kusht i kërkuar;
- Në po atë vit në të cilin fitimet ose shpërblimet e marra i kalojnë limitin e 45 mijë euro. Në rastin e fundit është e detyrueshme derdhja e Iva nepërmjet ndarjes së shumave të dokumentuara.

Sanksionet

Deklarimi i pasaktë i të dhënave për të përfituar nga rregjimi lehtësues përçakton ndërprerjen e tij dhe sanksionet e zakonshme rriten me 10 për qind nëse të ardhurat më të mëdha të vërtetuara i kalojnë 10 për qind ato të deklaruara.



INFORMAZIONE E ASSISTENCĒ

Sito Internet

Për informacione, formular, normativa, shërbime on-line

- www.agenziaentrate.gov.it

Për të gjetur me lehtësi zyrën e duhur :

- www.agenziaentrate.gov.it “Trova l’ufficio”
- **848.800.333** (shërbim automatik)

Cup - Rregjistrime e Takime

Për të rregjistruar një takim pranë zyreve të Agjencisë për të evituar pritjet e kota në sportele

- www.agenziaentrate.gov.it
- **199.126.003**

(shërbimi automatik) aktiv 24 orë.

Qendra e asistencës multicanale (CAM)

per të rregjistruar një thirrje duke zgjedhur ditën e orën www.agenziaentrate.gov.it

Për tu lidhur me operatorët e Agenzia delle Entrate

Nga e hëna deri të premten nga ora 9 deri në orën 17 e të shtunën nga ora 9 deri në orën 13 në numerat:

848.800.444

(shërbim me operator)

848.800.333

(shërbim automatik)

199.148.398

(numër për të kontaktuar CAM me celular)



Provincia Autonoma di Trento
Assessorato alle politiche sociali
Centro informativo per l’immigrazione

CINFORMI Italia – Trento – Via Zambra 11
tel +39 0461 405600 – fax +39 0461 405699
e-mail cinformi@provincia.tn.it
sito internet www.cinformi.it

albanese



Rregjim i ri tatimor për sipërmarrës të vegjël e profesionista

pa Iva e libra llogarie, pa Irap e studime të sektorit, vetëm taksë zevëndësuese me 20% mbi të ardhurat

DUKE FILLUAR NGA 2008 TAKSAPAGUESIT MINIMI KALOJNË AUTOMATIKISHT NË NJË RREGJIM TË RI TATIMOR ME:



Thjeshtim, reduktim të plotësi-meve e si rrjedhim zvoglim të kostos.

Kush janë taksapagues minimi?

Ndërrmarrje individuale e profesionist të vetëm që:

1) Në vitin e kaluar:

- Kanë patur fitime ose shpërblime të cilat nuk i kanë kaluar 30.000 euro;

- Nuk kanë patur punonjës ose bashkëpunëtorë (edhe për një kohë të caktuar),
 - Nuk kanë kryer tjetërsim në eksportim;
 - Nuk kanë nxjerrë përfitime nga pjesmarrja e ortakëve të cilët kanë kontribuar vetëm me punë;
- 2) Në trevjeçarim e mëparshëm nuk kanë kryer blerje të pasurive prodhuese me një shumë më të madhe se 15.000 euro;
- 3) Fillojnë aktivitetin e deklarojnë plotësimin e kushteve të pikave 1) e 2).

Mund të zgjedhin rregjimin e ri që nga 2008 edhe taksapaguesit “minimi in franchigia” që kishin votuar për rregjimin e zakonshëm.

Kujdes

Nuk mund të konsiderohen taksapagues minimi :

- Kush aplikon rregjim special Iva (p.sh editoria);
- Jo rezidentët
- Kush ekskluzivisht ose kryesisht kryen një aktivitet të tjetërsimit të pasurive (ndërtesa e troje ndërtimi) e të mjeteve të reja të transportit;
- Kush, njëkohësisht, merr pjesë në organizata , shoqata profesionale ose në organizata me përgjegjësi të përcaktuar.

CILAT JANË AVANTAZHET?

Irpef e mbitaksat

Nuk zbatohen më Irpef e mbitaksat rajonale e komunale.

Rregjimi i ri sjell zbatimin e një TAKSE ZËVËNDËSUESE ME 20 PËR QIND mbi fitimin, llogaritur si diferencë mes fitimit ose shpërblimeve e shpenzimeve të bëra përfshirë mbivlerat e nënvlerat e pasurive që kanë të bëjnë me ndërrmarrjen ose profesionin.

Të ardhurat përcaktohen duke aplikuar -il principio di cassa-, i cili sjell një nxjerrje të menjëhershme e të plotë të kostove, edhe të atyre që kanë të bëjnë me pasuritë prodhuese (rrethana shumë stimuluese sidomos në fazën e fillimit të aktivitetit prodhues).

Nga të ardhurat mund hiqen të tëra kontributet e sigurimeve, përfshirë edhe pagesat për bashkëpunëtorët e ndërrmarrjeve familjare në ngarkim nga ana tatimore si dhe ato të derdhura për bashkëpunëtorët jo në ngarkim por për të cilët titullari nuk ka ushtruar “të drejtën e zhdëmtimit”. Është përfshirë kompensimi i humbjeve të sjella nga vitet e mëparshme.

Humbjet fiskale të mëtejshme mund të paraqiten në zvoglim në të ardhurat e marra në periudhat e taksave në vazhdim, por jo mbas të pestës.

Iva

Përrjashtim nga plotësimet me qëllim Iva:

Pa pagesa, deklarime, komunikime, mbajtje e ruajtje rregjistrash.

Kujdes

Faturat duhet të jepen pa debitim Iva e nuk hiqet Iva nga blerjet: si rrjedhim Iva transformohet në një kosto të deduktueshme nga të ardhurat.



Irap

Përrjashtimi nga Irap me pasojë blerjen zero totale të kostove që kanë të bëjnë me taksat.

Studimet në këtë sektor

Përrjashtim nga aplikimi i studimeve në këtë sektor me një avantazh të pamohueshëm, e ravigjzuar në reduktimin e kostove e plotësimeve të lidhura me to.



Plotësime dokumentare

Përrjashtim nga detyrimet për rregjistrimin e mbajtjen e rregjistrave kontabile.

Përrjashtim nga nisja e listave të klientëve e të furnizuesve.

Mbetet e detyrueshme:

- Numërimi e ruajtja e faturave të blerjes e të faturave doganore
- Vërtetimi i kompensimeve
- Ruajtja e dokumentave të nxjerra e të marra
- Plotësimi i faturave të blerjes nderkomunitare ose në rregjim të “reverse charge”.